

VENDIM
Nr. 810, datë 28.12.2023

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 478, DATË 10.7.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PROCEDURËN E SIGURISË SË GJYQTARËVE TË GJYKATAVE KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR, TË PROKURORËVE TË PROKURORISË SË POSAÇME DHE DREJTORIT TË BYROSË KOMBËTARE TË HETIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 47, të ligjit nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë dhe të ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 478, datë 10.7.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurën e sigurisë së gjyqtarëve të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme dhe drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas fjalisë së parë, të pikës 2, shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Mbrotjtja personale mund të ofrohet edhe në bazë të kërkesës së thjeshtë të paraqitur, sipas rastit, nga kryetari i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Kryetari i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ose Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.”.

2. Në pikën 3 bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Togfjalëshi “oficer nënoficer” zëvendësohet me fjalët “... trupprojë të nivelit bazë dhe trupprojë të nivelit të mesëm ...”;

b) Në fund të pikës shtohen fjalët “... gjatë kohëzgjatjes së mandatit dhe për një afat jo më shumë se 2 vjet pas përfundimit të tij.”.

3. Pas pikës 3 shtohen pikat 3/1 dhe 3/2, me këtë përmbajtje:

“3/1. Mbrotjtja personale e gjyqtarëve të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme garantohet me shoqërim me një trupprojë të nivelit të mesëm.

3/2. Në raste të veçanta dhe me kërkesë të tyre, subjekteve të parashikuara në pikën 3, gjatë vizitave zyrtare jashtë vendit u garantohet shoqërimi me trupprojë të nivelit të mesëm.”.

4. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Masat shtesë për mbrotjtjen e veçantë personale të familjes dhe pasurisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Prokurorisë së Posaçme në rast të rrezikut për jetën, shëndetin e tij/saj ose familjes dhe pasurisë përcaktohen dhe jepen sipas rregullave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për mbrotjtjen e veçantë të magistratit.”.

5. Në pikën 8, pas fjalëve “... një përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit ...” shtohen “... një përfaqësues nga Garda e Republikës së Shqipërisë ...”.

6. Pika 12 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“12. Trupprojat e gjyqtarëve, prokurorëve, familjeve dhe banesave të tyre caktohen dhe zëvendësohen vetëm pasi të jetë marrë, paraprakisht, miratimi i kryetarit të Gjykatës, drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme apo drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit.”.

II. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, kryetarët e gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit, Garda e Republikës së Shqipërisë dhe Policia e Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama